



UNMIK/REG/2005/23
9 maj 2005

RREGULLORE NR. 2005/23

**MBI SHPALLJEN E LIGJIT PËR TRANSPORTIN RRUGOR TË MIRATUAR NGA
KUVENDI I KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Në pajtim me nenet 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke marrë parasysh komunikatën e lëshuar nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës më 4 prill 2005 lidhur me Ligjin mbi transportin rrugor, fillimisht të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 15 janar 2004, me ndryshimet e miratuara më 23 korrik 2004 nga një panel special treanëtarësh, i cili ka vepruar në mbështetje të paragrafit 9.1.41 të Kornizës Kushtetuese mbi Vetëqeverisje dhe veprimit të ndërmarrë pas kësaj nga Kuvendi i Kosovës më 24 mars 2005,

Duke vënë re se dispozitat e Ligjit nuk i cenojnë kompetencat e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, apo kompetencat dhe përgjegjësitë e tij të rezervuara sipas Kornizës Kushtetuese mbi Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe veçanarisht sipas neneve 8.1(q) dhe 8.1(r) të Kornizës Kushtetuese mbi Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Duke vërejtur me kohë dhe pa cenuar Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/12 të datës 13 qershor 2002 mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit,

Me anë të kësaj shpall Lgjin mbi transportin rrugor të miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji nr. 2004/1) më 24 mars 2005, që i bashkëngjitet kësaj Rregulloreje, i cili hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Nënshkruar sot, më 9 maj 2005

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm